



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

**RAPORT VJETOR PËR SHQYRTIMIN E
PROGRESIT TË KËRKIMEVE TË
STUDENTIT DOKTORANT NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA**

Viti akademik
2021 - 2024

LISTA E SHKURTESAVE

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

MAS-Ministria e Arsimit dhe Sportit

FGJH - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

NJSBC - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

GVB – Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

TABELA E LËNDËS

LISTA E SHKURTESAVE	2
I. HYRJE.....	4
II. ZHVILLIME NË KURRIKULËN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM:	5
2. INFRASTRUKTURA & LOGJISTIKA	8
3. AKTIVITETET E ZHVILLUARA PËR CIKLIN E TRETË:.....	10
1. KONFERENCA të Fakultetit dhe UT, me pjesëmarrje dhe të studentëve doktorantë	10
2. SIMPOZIUME, TRAJNIME.....	11
3. Aftësimi profesional e personal i doktorantëve (Ditë Studimore, Ditë Studimore Transversale)	12
Ditët studimore për Doktorantët:.....	12
III. Lidhja e programeve të studimit me tregun e punës.....	13
IV. Vlerësimi nga doktorantët (Pyetësi "Formular për shqyrtimin e progresit të kërkimeve të studentit" SHTOJCA NR. 1)	13
Mekanizma të tjerë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.....	20
V. Pikat e Forta.....	25
VI. Aspekte për t'u përmirësuar.....	26
VII. Përfundime dhe rekomandime:	27
Aneks 1.....	29

I. HYRJE

Baza ligjore, konteksti dhe qëllimi i raportit

Ky raport vjen në kuadër të politikave të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në dokumentet e mëposhtme:

1. Ligji nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (neni 6, 33, 38, 46, 87, 98, 99, 103, 104);
2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, VKM nr. 531, datë 11.9.2018, Shtojca nr. 2, 3 dhe 4
3. Statuti i UT-së, 2018;
4. Rregullore e UT-së, 2022;
5. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë e UT-së, 2020;
6. Rregullore për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë në UT, 2022;
7. Manuali i cilësisë në UT;
8. Paketa e instrumenteve të cilësisë, 2020;
9. Rregullore për funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, 2022.

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë kryesore dhe ato bazë të FGJH për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe të programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Raporti paraqet të dhëna domethënëse për vitet akademike 2021 - 2024 të cilat janë tregues për cilësinë e veprimtarive akademike në FGJH si dhe të dhënat e përfutuara nga anketimet e kryera në të njëjtin vit akademik për ciklin e tretë të studimeve, për të gjithë departamentet e FGJH-së të përmbledhura në raportet vjetore të cilësisë të njësive bazë në FGJH.

Analiza dhe rekomandimet në mbyllje të raportit synojnë orientimin e veprimtarive në vazhdim për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë.

II. ZHVILLIME NË KURRIKULËN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE

Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor” dhe synon të nxisë kërkimin

shkencor në një fushë të caktuar për të sjellë risi në mendimin shkencor dhe prurje me interes dhe dobi shoqërore.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM:

Që prej rihapjes së programit të ciklit të tretë të studimeve “Doktoraturë” në vitin akademik 2021-2022 në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ku u regjistruan 21 studentët e parë doktorantë, të gjitha aktivitetet shkencore kanë patur pjesëmarrjen aktive të tyre: konferenca kombëtare e ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara dhe jo, simpoziume, tavolina të rrumbullakëta, workshope etj. Aktualisht janë 74 studentë doktorantë aktivë. Studentët doktorantë janë gjithashtu pjesë e grupeve mësimore kërkimore (20 ekiye në nivel departamental), ku janë pjesë e zhvillimit të projekteve të ndryshme së bashku me stafin akademik të institucionit. Një bashkëveprim i tillë u mundëson atyre përvetësim më të mirë të aftësive të tyre profesionale kërkimore e duke projektuar njëkohësisht gjenerim të ideve të reja mbi mbi këto hulumtime. **Fusha kryesore e kërkimit** është: Shkenca Humane, ndërsa **nënfusha e kërkimit**: Doktoratë në “Shkenca Gjuhësore” dhe “Letërsi botërore moderne dhe postmoderne”.

Studentët doktorantë janë përfshirë në projektet kërkimore-shkencore, të zhvilluara nga njësia bazë përkatëse. Më poshtë një panoramë e përgjithshme e projekteve me tematikat dhe numrin e studentëve për secilin departament.

PROJEKTET KËRKIMORE-SHKENCORE DHE ZHVILLIMIT SIPAS DEPARTAMENTEVE:

➤ NËNFUSHA “SHKENCA GJUHËSORE”

✓ DREJTIMI KRYESOR: “GJUHËSI E ZBATUAR DHE KRAHASUESE”

i. Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE:

- Krahاسimi i dukurive gjuhësore në shqipe dhe anglisht -> **5 studentë** të atashuar në këtë projekt
- Gjuhësia e zbatuar në edukim-> **4 studentë** të atashuar në këtë projekt

ii. Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

- Gjuhësi e zbatuar në mesimdhënien e gjuhës së huaj->**2 studentë** të atashuar në këtë projekt
- Krahاسimi i dukurive gramatikore të shqipes dhe rusishtes-> **1 student i** atashuar në këtë projekt

iii. Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

- Hulumtimi i dallimeve dhe ngjashmërive gjuhësore mes gjermanishtes dhe shqipes në disiplinat kryesore të gjuhësisë -> **1 student** i atashuar në këtë projekt

iv. Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE

- Qasje strategjike dhe metodologjike të përvetësimit të leksikut në studentë të gjuhës greke në një kontekst dominues shqiptar -> **3 studentë** të atashuar në këtë projekt

✓ **DREJTIMI KRYESOR: MËSIMDHËNIE E GJUHËS SË HUAJ**

v. Projekte kërkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE:

- Mësimdhënia e leximit në anglisht në shkollën shqiptare: përvoja dhe sfida - **18 studentë** të atashuar në këtë projekt
- Mësimdhënia e integruar e gjuhës së huaj bazuar në harmonizimin e metodave tradicionale me ato bashkëkohore: sfidat në kontekstin shqiptar - **1 student** i atashuar në këtë projekt
- Integrimi i teknologjisë dhe aftësive të inovacionit (mendimi kritik, komunikimi, bashkëpunimi dhe kreativiteti) në mësimdhënien e gjuhës së huaj krahas zhvillimit të aftësive bazë (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lëxuarit) - **5 studentë të** atashuar në këtë projekt

vi. Projekte kërkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

- Integrimi i teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në klasën e gjuhës së huaj dhe në formimin e mësuesve - **2 studentë** të atashuar në këtë projekt

vii. Projekte kërkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

- Aspekte të kërkimit shkencor në mësimdhënien /mësimnxënien e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në kontekstin shqiptar - **1 student** i atashuar në këtë projekt

viii. Projekte kërkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE

- Përvetësimi i gjuhës gjermane me fokus në kompetencat dhe shprehitë gjuhësore. Konsiderata metodologjike dhe didaktike mbi vlerësimin e aftësive gjuhësore në gjermanisht (fokusi kompetenca e të shkruarit dhe të folurit) - **4 studentë të** atashuar në këtë projekt

✓ **DREJTIMI KËRKIMOR: “GJUHËSI KOMPJUTERIKE E ZBATUAR”**

ix. **Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE:**

- Trajtimi automatik i gjuhës për qëllime specifike - **2 studentë të** atashuar në këtë projekt

✓ **Drejtimi kërkimor: “Komunikim ndërkulturor”**

x. **Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE**

- Komunikimi verbal dhe joverbal, masmedia - **3 studentë të** atashuar në këtë projekt

✓ **DREJTIMI KËRKIMOR “STUDIME PËRKTHIMORE DHE TË INTERPRETIMIT”**

xi. **Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

- Vlerësimi i cilësisë së përkthimeve të romaneve, apo tregimeve të shkruar në gjuhën angleze nga autorë të ndryshëm dhe mënyra se si janë përcjellë në gjuhën shqipe nga dy ose më shumë përkthyes - **1 student**

TË GJITHA DEPARTAMENTET

- Përkthimi (Ripërkthimi) letrar - **5 studentë të** atashuar në këtë projekt
- Përkthimi tekniko-shkencor - **3 studentë të** atashuar në këtë projekt
- Përkthimi multimedial - **1 student** i atashuar në këtë projekt
- Kërkimi shkencor në përkthim dhe interpretim - **4 studentë të** atashuar në këtë projekt
- Kontributi i studiuesve shqiptarë në studimet përkthimore dhe të interpretimit në shekujt XX dhe XXI - **1 student** i atashuar në këtë projekt

➤ **NËNFUSHA E KËRKIMIT: “LETËRSI BOTËRORE MODERNE DHE POSTMODERNE”**

Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE

- Letërsia moderne dhe postmoderne amerikane dhe shumësia e dreitimeve të saj në epokën bashkëkohore - **2 studentë të** atashuar në këtë projekt
- Letërsia moderne dhe postmoderne britanike dhe shumësia e dreitimeve të saj në epokën bashkëkohore - **1 student i atashuar në këtë projekt**

Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE

- Ndjeshmëria poetike e shkrimtareve femra në Greqinë pas viteve 1930 - **2 studentë të** atashuar në këtë projekt

Projekte kerkimore-shkencore DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE

- Letërsia italiane dhe feja/historia/gjeografia/sociologjia/pushteti.... - **2 studentë të** atashuar në këtë projekt

Numri total i personelit akademik të angazhuar është 56. Drejtuesit shkencorë të doktorantëve duhet të kenë titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar” dhe mund të udhëheqin, respektivisht, një numër të caktuar doktorantësh në të njëjtën kohë dhe të respektojnë përcaktimet e nenit 65 të ligjit nr.80/2015. Ky numër përfshin të gjitha udhëheqjet që personeli akademik i kategorisë “Profesor” ndjek në të gjitha institucionet e arsimit të lartë ku ai është i angazhuar.

2. INFRASTRUKTURA & LOGJISTIKA

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i mundëson studentëve doktorantë kapacitetet e nevojshme infrastrukturore për zhvillimin e programit të studimit:

A. LABORATORËT:

1. Laboratori Dixhital i Gjuhës së Shenjave Shqipe (106), kapaciteti në vënde pune 18;
2. Laboratori Dixhital 1 (107), kapaciteti në vënde pune 22;
3. Laboratori i Trajtimit Automatik të Gjuhëve (208), kapaciteti në vënde pune 24;
4. Laboratori Kërkimor “DiPLling” (210), kapaciteti në vënde pune 17;
5. Laboratori i Studimeve Ndërkulturore (211), kapaciteti në vënde pune 24;
6. Laboratori i Kërkimit Shkencor (212), kapaciteti në vënde pune 24;
7. Laboratori i Fonetikës (213), kapaciteti në vënde pune 24;
8. Laboratori i Trajnimeve dhe Inovacionit (214), kapaciteti në vënde pune 24;
9. Laboratori i Përkthimit dhe Interpretimit (310), kapaciteti në vënde pune 35;
10. Laboratori i Përkthimit dhe Interpretimit “Artur Sula” (313), kapaciteti në vënde pune 21.

B. BIBLIOTEKAT

Gjithashtu studentët doktorantë kanë mundësi përdorimi të bibliotekave të profilizuara për hulumtimet e tyre kërkimore-shkencore: Më poshtë është dhënë kapaciteti fizik i tyre, i shprehur në vende/poste punë kërkimi:

Në sallën **ARGJIRO** janë vendosur librat në gjuhët angleze, italiane dhe spanjolle.

Në sallën **ROZAF** janë vendosur librat në gjuhët frënge, gjermane dhe në ato sllavo-ballkanike (ruse dhe greke).

Sipërfaqja e bibliotekës është **242m²**.

Sipërfaqja e Sallës “Argjiro” është **121 m²** dhe ajo e sallës “Rozafa” **121 m²**.

Numri i vendeve për sallë është përkatësisht:

Argjiro – 40; **Rozafa** – 40, pra, gjithsej: **80** vende.

Numri i posteve të punës (i kompjuterëve) **është 2** (një në sallën “Rozafa” dhe një në sallën “Argjiro”).

Fondi, arkivi i librave në Bibliotekën e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është në shtatë gjuhë, përkatësisht:

FONDI I BIBLIOTEKËS SË FGJH-së Gjendja Shkurt 2025

DEGA / NR.I LIBRAVE PËR SECILËN GJUHË / NR. TITUJVE (i librave me nga 1 kopje)

Anglisht	4406	2418
Frengjisht	6366	4327
Gjermanisht	6116	3717
Greqisht	791	384
Italisht	2810	2420
Rusisht	783	406
Spanjisht	874	690
GJITHSEJ	22 146	14238 (Tituj gjithsej, ose libra me nga 1 kopje)

Në bibliotekë kemi koleksionin e periodikëve:

1. **REVISTË SHKENCORE E FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA** e cila është regjistruar me **numër DOI** për publikim (Numri i parë ka dalë në vitin 2019; gjithsej në bibliotekë janë 7 numra);
2. **Albanische Universitätsstudien** (Studime universitare shqiptare, botohet në Gjermani; gjithsej 10 numra.);
3. **Zeitschrift fuer Germanistische Sprach-und Literaturwissenschaft “Dituria”** (botohet në Gjermani; gjithsej 12 numra).

3. AKTIVITETET E ZHVILLUARA PËR CIKLIN E TRETË:

Aktivitetet që zhvillohen në kuadër të programit doktorial të ciklit të 3-të të studimit janë të shumta duke pasur parasysh fushën e studimit dhe objektivat e kërkimit. Nisur nga kjo, aktivitetet e zhvilluara janë bazuar në hulumtimin shkencor, pjesëmarrjen në seminare dhe konferenca, seminare këshillimi dhe mentorimi, workshope dhe trajnime shkencore, ditë studimore, si dhe konkurse. Nëpërmjet aktivitete të tilla studentët patën mundësi të zhvillohen si hulumtues të pavarur dhe të kontribuojnë në përparimin e njohurive shkencore në fushën e tyre.

Që prej rihapjes së programit të ciklit të tretë të studimeve “Doktoraturë” në vitin akademik 2021-2022 në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, ku u regjistruan 21 studentët e parë doktorantë, të gjitha aktivitetet shkencore kanë patur pjesëmarrjen aktive të tyre: konferenca kombëtare e ndërkombëtare të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të financuara dhe jo, simpoziume, tavolina të rrumbullakëta, workshope e tj.

Aktualisht janë 74 studentë doktorantë aktive.

Studentët tanë doktorantë janë gjithashtu pjesë e grupeve mësimore kërkimore, ku janë pjesë e zhvillimit të projekteve të ndryshme së bashku me stafin akademik të institucionit. Një bashkëveprim i tillë u mundëson atyre përvetësim më të mirë të aftësive të tyre profesionale kërkimore e duke projektuar njëkohësisht gjenerim të ideve të reja mbi këto hulumtime.

1. KONFERENCA të Fakultetit dhe UT, me pjesëmarrje dhe të studentëve doktorantë

- Konferenca ndërkombëtare, dhjetor 2022, “*Si ta bëjmë trashëgiminë tonë kulturore të flasë? – Kreativitet dhe ndërmjetësim në njohjen e trashëgimisë kulturore*”, <https://fgjh.edu.al/si-ta-bejme-trashegimine-tone-kulturore-te-flase-kreativitet-dhe-ndermjetesim-ne-njohjen-e-trashegimise-kulturore/>

- Tetor 2023, konferenca ndërkombëtare “*Didaktika e gjuhëve të huaja: nga politikat gjuhësore në qasjet për një kopetencë shumëgjuhëshe*” <https://fgjh.edu.al/konferenca-nderkombetare-shkencore-didaktika-e-gjuheve-dhe-kulturave-te-huaja-nga-politikat-gjuhesore-ne-qasjet-per-nje-kompetence-te-shumegjuhesise/>

- Prill 2023, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me temë “*Përkthimi dhe Komunikimi, Sfidat dhe Përparësitë në rrafshin ndërkombëtar*” e organizuar nga Departamenti i Gjuhës Greke në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Angleze, Universitetin Ionian të Korfuzit dhe Fondacionin Grek të Kulturës. <https://fgjh.edu.al/konferenca-shkencore-nderkombetare-perkthimi-dhe-komunikimi-sfidat-dhe-perparesite-ne-rrafshin-nderkombetar/>

- Maj 2023, Konferenca Ndërkombëtare Studentore “*Kërkimi shkencor dhe edukimi në perspektivën e studentëve dhe studiuesve të rinj – UT flet me zërin e studentëve*”, me pjesëmarrjen e 295 studentëve dhe studiuesve, nga 29 institucione publike dhe private, ku u prezantuan plot 128 studime e punime nga të gjitha fushat: gjuhësi, albanologji, shkenca juridike shkenca sociale e shkenca të natyrës <https://fgjh.edu.al/konferenca-nderkombetare-studentore-kerkimi-shkencor-dhe-edukimi-ne-perspektiven-e-studenteve-dhe-studiuesve-te-rinj-ut-flet-me-zerin-e-studenteve/>

- Maj 2023, Departamenti i Gjuhës Italiane, organizoi Konferencën e 14-të Ndërkombëtare të Studimeve Italianistike <https://fgjh.edu.al/konference-e-departamentit-te-gjuhes-italiane/>
- Maj 2023, Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë bosht “*Terminologjia në fushat humane dhe pasqyrimi i saj në fjalorë*” <https://fgjh.edu.al/konference-shkencore-nderkombetare-terminologjia-ne-fushat-humane-dhe-pasqyrimi-i-saj-ne-fjalore/>
- Maj 2023, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në bashkëpunim me Institutin Servantes në Romë dhe Departamentin e Studimeve Hispanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja organizoi konferencën me temë: “*Spanjishtja, Gjuhë Globale*”. <https://fgjh.edu.al/spanjishtja-gjuhe-globale-2/>
- Tetor 2024, Departamenti i Gjuhës Italiane, në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës - Konferenca e 16-të Ndërkombëtare të Studimeve Italianistike <https://www.facebook.com/FAKULTETiGJUHEVEteHUAJAIUT>
- Nëntor 2024, departamenti i gjuhës angleze organizoi Konferencën e 13-të Ndërkombëtare, në kuadër të Projektit “*Përmirësimi i kërimit shkencor me kërkuesit e rinj të Departamentit të Gjuhës Angleze*” <https://fgjh.edu.al/konferenca-e-13-te-nderkombetare-permiresimi-i-kerkimit-shkencor-me-kerkuesit-e-rinj-te-departamentit-te-gjuhes-angleze/>
- 21 nëntor 2024, Departamenti i Gjuhës Angleze - Konferencën e 14-të Ndërkombëtare <https://www.facebook.com/FAKULTETiGJUHEVEteHUAJAIUT>
- Dhjetor 2024, Konferenca shkencore studentore ndërkombëtare “*Kërkimi shkencor dhe edukimi në perspektivën e studentëve dhe të studiuesve të rinj- UT flet me zërin e studentëve*”, edicioni II, 12 dhjetor 2024. <https://ëëë.facebook.com/FAKULTETiGJUHEVEteHUAJAIUT>

2. SIMPOZIUME, TRAJNIME

- 2 shkurt, 2024, Tavolina e rrumbullakët “*Risitë kërkimore të projekteve të realizuara; nxitje për gjenerimin e ideve të reja bashkëpunuese*”, Faculty Research Day FGJH 24 <https://ëëë.facebook.com/profile/100069557301802/search/?q=shkurt%202024>
- Tetor 2024. Departamenti i Gjuhës Spanjolle, Simpoziumi Ndërkombëtar mbi Letërsinë dhe Kulturën Hispanike në bashkëpunim me Universitetin e Castilla - La Mancha, me Universiteti Internacional de Cataluña, Universitetin e Ankarasë dhe Universitetin e Stambollit.
- Shkurt 2025, Në Ditën e Kërimit Shkencor në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (Faculty Research Day 2025), Fakulteti i Gjuhëve të Huaja organizoi simpoziumin shkencor me temën “*Risitë kërkimore dhe nxitja e bashkëpunimit shkencor në FGJH*” me pjesmarrjen e 20 grupeve mesimore kërkimore dhe studenteve doktorante ku u diskutuan mbi risitë e hulumtimeve dhe projekteve të ndërmara, si dhe mbi perspektivat për zhvillimin e kërimit në fushën e shkencave humane.
- Mars 2025, “*Teknologjia digjitale për zhvillimin e kompetencave të komunikimit në gjuhë të huaj*” nga Prof. Asoc. Dr. Elona Toro. Në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të personelit akademik dhe studiuesve të rinj

- Mars 2025, trajnimi me temë "*Design Thinking dhe Inovacioni*" me profesor Artan Fugën, profesor i komunikimit në Universitetin e Tiranës dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ky trajnim shërbeu si një mundësi shumë e mirë për studentët dhe pedagogët për t'u njohur me metodat inovative të mendimit krijues dhe zbatimet praktike në fushat e arsimit, sipërmarrjes dhe menaxhimit.

3. Aftësimi profesional e personal i doktorantëve (Ditë Studimore, Ditë Studimore Transversale)

Ditët studimore për Doktorantët:

Përgjatë vitit akademik, studentët doktorantë janë përfshirë në aktivitetet shkencore të organizuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në nivel departamentor dhe të njësisë kryesore: që nga projektet shkencore, konferencat shkencore ndërkombëtare dhe ndërkombëtare, brenda dhe jashtë vendit, seminare, workshope, etj., si psh:

Ditët Studimore zhvillohen rregullisht çdo vit me studentët doktorantë, në kuadër të programit të doktoraturës, mbi rritjen e kompetencave të tyre në tematika të ndryshme si:

- Zgjedhja e korpusit studimor
- Si të shkruajmë një artikull
- Përzgjedhja e bibliografisë dhe citimi i saj
- Aksesimi i literaturës bashkëkohore akademike
- Analiza e të dhënave cilësore dhe sasiore
- Shkrimi tezës së doktoraturës
- Sistemet përlogaritëse të të dhënave të disertacionit: statistika sasiore dhe cilësore
- Si të shkruajmë një artikull Scopus
- Risetë metodologjike të disertacionit

1. Mars 2023, Në kuadër të "Pranverës së Frankofonisë në Shqipëri", Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës, Universitetin e Shkodrës, Ambasadës Franceze në Shqipëri, Agjencinë Universitare të Frankofonisë, me nismën e Grave Frankofone, u organizua Edicioni i 6-të i Forumit të Grave Shqiptare Frankofone me temë "*Inovacioni dhe teknologjia për fuqizimin e gruas - Figura e gruas në rrjetet sociale*", me pjesëmarrje dhe të studenteve doktorantë.
2. Tetor 2023, Konferenca ndërkombëtare e FGJH-së "*Didaktika e gjuhëve dhe kulturave të huaja: nga politikat gjuhësore në qasjet e mësimdhënies/nxënies për një kompetencë të shumëgjuhësisë*"
3. Shkurt 2024, Seminari shkencor në Ditën e Kërkimit FGJH "*Risetë kërkimore të projekteve të realizuara, nxitje për gjenerimin e ideve të reja bashkëpunuese*"
4. Maj 2024, Seminari Ndërkombëtar Shkencor me temë: "*Dëshmi të kërkimeve shkencore aktuale në fakultetet tona përkatëse: metoda inovative në kërkim dhe teknologji të reja*",

me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve nga Universiteti i Poitiers dhe të pedagogëve e studentëve të FGJH-UT dhe studentëve doktorantë

5. Qershor 2024, studentët doktorantë morën pjesë në Konkursin MT 180' Shqipëri, aktivitet shkencor organizuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës dhe me Ambasadën e Francës në Shqipëri. “*Ma thèse en 180*” edicioni 2024 u organizua në Shqipëri!

III. Lidhja e programeve të studimit me tregun e punës

Programeve të studimit të ofruara nga FGJH-ja janë të hartuara bazuar në kompetenca (bazë të fushës/profesionale), të cilave u korrespondojnë rezultatet dhe aftësitë përkatëse të të nxënit që synojnë aftësimin vetjak dhe organizimit të pavarur, aftësimin shoqëror dhe komunikues, njohuri bazë të gjuhëve të studimit, njohuri rreth letërsisë, kulturës dhe historisë së vendeve gjuhën e së cilës studiojnë, aftësim për të kryer kërkim për çështje gjuhësore, letrare e kulturore, njohuri rreth çështjeve si komunikim ndërkulturor, kompetencë ndërkulturore, takime kulturore, mësimdhënie, përkthim dhe interpretim sipas profileve të studimit.

Diplomat e marra nga studentët e diplomuar në tërë ciklet e studimeve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja njihen në Evropë duke u krijuar mundësi për studime të mëtejshme dhe/apo punësim, jo vetëm në drejtimet dhe programet e studimit në FGJH por në një shumëllojshmëri programesh të tjera studimi, si në studimet e ciklit të dytë ashtu dhe ato të ciklit të tretë.

Në ciklin e tretë, studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Studimet e doktoratës zhvillohen në formën e grupeve kërkimore, që drejtohen nga personeli akademik, që ka titullin akademik “profesor i asociuar” ose “profesor”. Ato zgjasin jo më pak se tri vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike. Në përfundim të studimeve të doktoratës lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”.

Studimet e doktoratës zhvillohen me kohë të plotë pranë njësisë bazë ose me kohë të zgjatur në ato raste kur doktoranti është i punësuar si personel akademik në një institucion tjetër të arsimit të lartë apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar.

IV. Vlerësimi nga doktorantët (Pyetësi “Formular për shqyrtimin e progresit të kërkimeve të studentit” SHTOJCA NR. 1)

Gjatë vitit akademik 2024 - 2025 është bërë vlerësimi për shqyrtimin e progresit të kërkimeve të studentit. Metodologjia e studimit është sasiore dhe cilësore. Pyetësorët e zhvilluar janë hartuar

në përputhje me paketën e instrumenteve të cilësisë e miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 51 datë 23.12.2020.

Pyetëtori përbëhet nga 14 pyetje të shtrira në seksionet kryesore:

1. Të dhëna të përgjithshme
2. Mbështetja institucionale
3. Seksion lidhur me udhëheqësin
4. Objektivat
5. Seksion për punësimin

Studenti i përgjigjet pyetjeve sipas vlerësimit individual si në vijim:

- Aspak
- Deri diku
- Mjaftueshëm
- Shumë

Gjithashtu ka patur edhe pyetje me përzgjedhjen e disa alternativave ose me po ose jo.

Hartimi dhe shpërndarja e pyetësorëve u krye nga Zyra e cilësisë në bashkëpunim me NJSBC FGJH dhe me NJSBC e njësive bazë. Rezultatet e pyetësorëve u mbledhën në mënyrë elektronike nga formati Teams Forms, u përpunuan në formatin Excel nga zyra e Cilësisë dhe e Kurrikulës dhe iu përcollën drejtuesit të njësive bazë, me qëllim diskutimin e përgjithshëm brenda njësive bazë dhe grupeve kërkimore shkencore për të evidentuar dhe analizuar në mënyrë kritike të dhënat e grumbulluara.

Në vijim paraqiten po parashtrijmë rezultatet në përqindje dhe analizat përkatëse për secilin seksion dhe pyetje në nivel fakulteti:


1. Informacion i Përgjithshëm

- **Departamentet:** Pyetëtori përfshin përgjigje nga departamente të ndryshme si Anglisht, Italisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Greqisht, Spanjisht dhe Turqisht.

- Përgjigjet janë nga studentë në vitin e parë (12 studentë), të dytë (18 studentë) dhe të tretë (23 studentë) të studimeve doktorale.

2. Në çfarë viti të doktoraturës jeni aktualisht:

• Vitin e parë	12
• Vitin e dytë	18
• Vitin e tretë	23
• Vitin e katërt	0
• Vitin e pestë	0




2. Koha e Përfundimit

- **Parashikimi i Përfundimit:** 81% e studentëve parashikojnë se do ta përfundojnë disertacionin në kohë, ndërsa 19% tregojnë se mund të mos e përfundojnë për shkak të ngarkesës së punës dhe sfidave të publikimit.

3. Parashikoni ta mbyllni disertacionin brenda afatit të parashikuar :

• PO	43
• JO	10



Nga të dhënat rezulton se pjesa më e madhe e studentëve doktorale synojnë përfundimin në kohë të përmbylljes së këtij cikli studimor. Gjithsesi duhet thënë se punimi i një disertacioni përmbën një sfidë më vete, duke shtuar dhe faktin se gjatë kësaj periudhe studimore, duhen shlyer kumtesat në konferenca shkencore, si dhe botimet e artikujve shkencor. Kjo gjë reflektohet edhe tek 19% e studentëve doktorantë.

3. Mbështetja Institucionale

- **Mbështetja nga Departamenti:** 66% e studentëve ndihen të mbështetur shumë nga departamentet përkatëse, 25% ndihen mjaftueshëm të mbështetur, 9% deri diku dhe 0% aspak.
- **Informacion për Konferenca dhe Publikime:** 68% e studentëve marrin shumë informacion për pjesëmarrje në konferenca, 24% mjaftueshëm, 8% deri diku dhe 0% aspak.
- **Mbështetja nga Dega e Kërkimit Shkencor:** 72% e studentëve ndihen shumë të mbështetur nga Dega e Kërkimit Shkencor, 21% mjaftueshëm, 7% deri diku dhe 0% aspak.

Mbështetja institucionale	Aspak	Deri diku	Mjaftueshëm	Shumë
A keni gjetur mbështetje nga Departamenti përkatës	0%	9%	25%	66%
A ju është ofruar informacion për pjesëmarrje në konferenca/kongrese/seminare kombëtare dhe ndërkombëtare	0%	8%	24%	68%
A ju është ofruar informacion lidhur me publikimet në revista brenda dhe jashtë vendit	0	15%	42%	43%
A ju është ofruar informacion lidhur me publikimet në revista me SCOPUS	2%	21%	49%	28%
A jeni ndër të mbështetur nga Dega e Kërkimit shkencor dhe personeli përgjegjës për doktoraturat	0	7%	21%	72%
Sa i është përgjigjur nevojave tuaja kjo degë	0%	6%	24%	70%

Në të dhënat e paraqitura më sipër rezultoi se pjesa më e madhe e tyre janë të kënaqur me mbështetjen e departamenteve përkatëse, kanë informacionin e duhur për konferencat dhe publikimet, si dhe përforcojnë mbështetjen nga Dega e Kërkimit Shkencor. Vihet re se një pjesë e konsiderueshme, konkretisht 49%, kanë mjaftueshëm informacion lidhur me publikimin në revistat Scopus. Duhet thënë se mbështetja institucionale e departamenteve për procesin doktorat është një komponent thelbësor për të siguruar që procesi i studimeve doktorale të zhvillohet në mënyrë efektive dhe të suksesshme. Kjo mbështetje mund të realizohet në disa nivele dhe përfshin aspekte të ndryshme, duke përfshirë administratën, burimet, dhe mësimdhënien. Këtu gjen diskutim edhe rritja për dhënien e informacioneve më të detajuara lidhur me revistat shkencore dhe publikimet në to.

4. Mbështetja nga Udhëheqësi

- **Interaksioni me Udhëheqësin:** 81% e studentëve ndihen shumë të mbështetur nga udhëheqësit e tyre, 13% mjaftueshëm, 2% deri diku dhe 4% aspak.

- **Udhëzimi për Publikime:** 77% e studentëve marrin shumë udhëzime për publikime nga udhëheqësit, 17% mjaftueshëm, 2% deri diku dhe 4% aspak.
- **Etika e Komunikimit:** 89% e studentëve besojnë se udhëheqësit i përmbahen etikës së komunikimit, 7% mjaftueshëm, 2% deri diku dhe 2% aspak.

Seksion lidhur me udhëheqësin:	Aspak	Deri diku	Mjaftueshëm	Shumë
A jeni ndjerë të mbështetur siç duhet nga udhëheqësi	4%	2%	13%	81%
A ju motivon ai mjaftueshëm në rastet kur kjo është e nevojshme	4%	2%	15%	79%
A ju ka ofruar ai informacionet e duhura dhe të mjaftueshme lidhur me kërkimin	6	0%	15%	79%
A keni diskutuar dhe rënë në dakordësi lidhur me çështje që kanë të bëjnë me temën dhe a janë të qarta komentet e tij	4%	2%	13%	81%
A ju ka drejtuar ai lidhur me publikimet: literatura, kontrolli, rishikimi, diskutimi, komentet lidhur me to	4	2%	17%	77%
A i përmbahet ai etikës së komunikimit	2%	2%	7%	89%
A e merrni në konsideratë ndërrimin e udhëheqësit	81%	2%	2%	15%

Të dhënat në tabelën e mësipërme tregojnë një qasje tejet të kënaqshme lidhur me mbështetjen që udhëheqësit i japin studentëve të tyre doktorantë. Mbështetja nga udhëheqësi i procesit doktorant është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ka një ndikim të thellë në suksesin e doktorantit. Udhëheqësi (zakonisht një profesor ose hulumtues me përvojë) luan një rol kyç në udhëzimin, mbështetjen dhe zhvillimin e doktorantëve gjatë gjithë periudhës së studimeve. Mbështetja e udhëheqësit është thelbësore për zhvillimin e suksesit të doktorantit, jo vetëm për shkallën e kërkimit shkencor, por edhe për zhvillimin profesional dhe personal të tij. Një marrëdhënie e fortë dhe mbështetëse me udhëheqësin është një faktor kyç që mund të përcaktojë ndjeshëm përfundimin e suksesshëm të procesit doktorant. Kjo gjë reflektohet dhe te 81% e të pyeturve, të cilët nuk e marrin fare në konsideratë ndërrimin e mentorit të tyre udhëheqës.

5. Objektivat për Vitin e Ardhshëm

- **Objektivat e përbashkëta:** Objektivat e ardhshme për studentët doktorantë varen nga fusha e kërkimit dhe faza e avancuar, në të cilën ata ndodhen. Objektivi kryesor i përbashkët i tyre mbetet përfundimi i punës kërkimore, që nënkupton mbylljen e shkrimit të temës dhe mbrojtjen e saj. Paralelisht me këtë, studentët doktorantë synojnë gjithashtu pjesëmarrjen në aktivitete

shkencore dhe konferenca. Shumë doktorantë kanë objektiv të botojnë artikuj kërkimorë në revista të njohura akademike për të rritur shikueshmërinë e punës së tyre dhe për të kontribuar në fushën e tyre. Pjesëmarrja në konferenca të nivelit të lartë është një mundësi për të ndarë rezultatet e kërkimit, për të marrë reagime nga kolegët dhe ekspertët, dhe për të ndërtuar një rrjet profesional. Siç shihet dhe në tabelën më poshtë, doktorantët kanë si objektiv edhe përfshirjen e tyre në projekte të ndryshme në rang fakulteti, universiteti, por edhe më gjerë. Kjo gjë i ndihmon ata në zhvillimin e aftësive profesionale të tyre, pasi përveç prezantimeve të kërkimit në konferenca, mund të jetë e rëndësishme që doktorantët të zhvillojnë aftësi në komunikimin e ideve të tyre me audienca të gjera, përfshirë publikun e gjerë dhe media. Gjithsesi vihet re se ka edhe studentë doktorantë, të cilët për arsye personale kanë si objektiv shtyrjen e përfundimit të disertacionit dhe mospërfundimin e tij në kohën e përcaktuar që në fillim.

Objektivat tuaja për vitin e ardhshëm janë:
Mbrojtja e temës
Shtyrja e temës për arsye personale
Në informacionet që na ofrohen për publikime
Në përfshirjen në projekte të FGJH/ UT/ AKKSHI

6. Nevojat për Punimin Doktorat

- **Nevojat e përbashkëta:** Për të zhvilluar një punim doktorat të suksesshëm, ka disa nevoja dhe kërkesa që duhet të merren parasysh. Shumë e rëndësishme për ta është përkrahja dhe mbështetja që duhet të kenë nga departamenti dhe udhëheqësi përkatës. Këtu ata theksojnë një komunikim më efikas që duhet të kenë me njëri-tjetrin. Duhet thënë se, nevoja për një drejtues që mund të udhëzojë në formulimin e hipotezave, dizajnimin e kërkimit, dhe në përgatitjen e punimit final, si dhe mbështetja për rishikimin dhe përmirësimin e materialeve të kërkimit, duke siguruar që punimi të jetë i qartë dhe shkencërisht i saktë, përbëjnë aspekte kyçe dhe tejet ndihmuese për këta studentë. Gjithashtu studentët shprehin nevojën për sisteme antiplagjiaturë, ditë studimore praktike, softuer SPSS për përpunimin e të dhënave, mundësi për publikime të paguara në revista të huaja, si dhe ndihmë financiare për përballimin e kosove të botimeve. Për shumë doktorantë, është e nevojshme të sigurohen financime për kërkimin, si grante ose bursat që mund të mbulojnë kostot e kërkimit (materiale, udhëtime për konferenca, etj.).

Cilat janë nevojat tuaja lidhur me punimin doktorat?	
1.	Një specialist statistikash mbështetës për analizat e nevojshme të të dhënave që dalin nga kërkimet.
2.	Ndihmë nga ana financiare për përballimin e kostove të botimeve në Scopus.
3.	Mbështetje më e madhe nga departamenti.
4.	Komunikim më efikas me udhëheqësin.

7. Punësimi gjatë Studimeve Doktorale

Punësimi gjatë studimeve doktorale është një temë e rëndësishme dhe mund të sjellë përfitime, por gjithashtu mund të paraqesë edhe sfida. Shumë doktorantë punojnë gjatë periudhës së doktoratës për të siguruar një burim të ardhurash, për të fituar eksperiencë profesionale, ose për të zhvilluar aftësi të tjera që mund t'i ndihmojnë pas përfundimit të studimeve. Megjithatë, është e rëndësishme që puna të mos pengojë kërkimin dhe përqendrimin te disertacioni. Nga vjelja e të dhënave rezulton se për sa i përket **statusit të punësimit**: 96% e studentëve janë të punësuar gjatë studimeve doktorale dhe 4% e tyre puna është e lidhur me fushën e studimit.


	Seksion për punësimin	Po	Jo
1.	A jeni aktualisht i punësuar gjatë ndjekjes së programit tuaj doktoratë?	96%	4%
2.	Nëse po, a është puna juaj e lidhur me fushën tuaj të studimit?	94%	6%
3.	A mendoni se përmbajtja dhe struktura e programit tuaj doktoratë ju ndihmon të zhvillonit aftësi që janë të vlefshme për tregun e punës?	96%	4%

Përmbajtja dhe struktura e një programi doktoratë mund të ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive që janë të vlefshme për tregun e punës, sidomos nëse programi është i dizajnuar për të balancuar kërkimin akademik dhe zhvillimin profesional. Nga të dhënat e mbledhura. Lidhur me **strukturën e programit** rezultoi se: 96% e studentëve besojnë se struktura e programit doktoratë i ndihmon të zhvillojnë aftësi të vlefshme për tregun e punës. Studimi doktoratë zhvillon aftësitë për të analizuar të dhëna dhe për të zhvilluar teori dhe praktika të reja, që janë të kërkuara në shumë fusha profesionale. Theksojmë, se një program doktoratë që është i strukturuar mirë dhe që ofron mundësi për zhvillim të aftësive profesionale dhe akademike do të ndihmojë studentët të jenë më të përgatitur për tregun e punës, qoftë në sektorin akademik. Aftësitë që zhvillohen gjatë doktoratës mund të ndihmojnë në karrierën e doktorantëve pas përfundimit të studimeve.

8. Rrjetëzimi dhe Perspektivat e Karrierës

10. A jeni aktualisht i punësuar gjatë ndjekjes së programit tuaj doktoratë?

● PO 51
● JO 2




Rrjetëzimi dhe perspektivat e karrierës janë dy aspekte shumë të rëndësishme gjatë dhe pas studimeve doktorale. Kjo është periudha kur krijohen mundësi për të lidhur kontakte me profesionistë dhe ekspertë në fushën e tyre, për të zbuluar mundësi të reja dhe për të përgatitur një rrugë të suksesshme profesionale për të ardhmen.

Sa më sipër, lidhur me **Rrjetëzimin**, studentët i konsiderojnë të dobishme kontaktet dhe rrjetëzimin gjatë programit doktoral për karrierën e tyre të ardhshme. Ndërsa për sa i përket **Sigurisë së punës**, studentët ndihen të sigurt për mundësitë e tyre për të gjetur punë në fushën e tyre pas marrjes së gradës Doktor i Shkencave.

Vëmë në dukje, se rrjetëzimi dhe perspektivat e karrierës gjatë doktoratës janë të rëndësishme për të krijuar mundësi profesionale dhe për të zgjeruar horizontet e mundshme për punësim pas studimeve. Pjesëmarrja aktive në ngjarje akademike dhe profesionale, zhvillimi i lidhjeve me mentorë dhe profesionistë, dhe ndërtimi i një rrjeti të fuqishëm mund të sigurojnë që karriera e tyre të zhvillohet në mënyrë të suksesshme.

11. Nëse po, a është puna juaj e lidhur me fushën tuaj të studimit?


● PO 50
● JO 3



Mekanizma të tjerë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit


Pyetësorët dhe kurset ekstrakurrikulare për doktorantët në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja luajnë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe përmirësimin e aktiviteteve akademike dhe profesionale. Pyetësorët, të cilët mbledhin opinione dhe vlerësime nga pjesëmarrësit, ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi organizimin, përmbajtjen dhe ndikimin e aktiviteteve të ndryshme, duke ndihmuar në identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta. Kurset ekstrakurrikulare, nga ana tjetër, ofrojnë mundësi të vlefshme për zhvillimin akademik dhe profesional të doktorantëve, duke mbështetur formimin e tyre cilësor dhe përgatitjen për sfidat e karrierës shkencore. Analiza e detajuar e këtyre elementeve është thelbësore për të siguruar një përvojë të suksesshme dhe efektive për studiuesit e rinj.

– Pyetësor për identifikimin e nevojave për trajnime për Doktorantët



Pyetësi për identifikimin e nevojave për trajnime për doktorantët në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja ka treguar një interes të lartë për tema të ndryshme trajnimi, duke përfshirë krijimin e korpuseve studimore dhe analizën e të dhënave. Rezultatet tregojnë se doktorantët kanë nevojë për aftësi të avancuara në këto fusha për të përmirësuar cilësinë e kërkimeve të tyre shkencore. Ndërkohë, temat si redaktimi i punimit dhe aksesimi i literaturës bashkëkohore akademike gjithashtu kanë marrë vlerësime pozitive, duke theksuar rëndësinë e këtyre aftësive në procesin e kërkimit. Analiza e rezultateve tregon se është e nevojshme të ofrohen trajnime të specializuara që adresojnë këto nevoja, duke përmirësuar kështu përgatitjen akademike dhe profesionale të doktorantëve. Për të maksimizuar efektivitetin e këtyre trajnimeve, rekomandohet që të përfshihen metoda interaktive dhe praktike që do të ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të kërkuesve të rinj.

- Pyetësor Vlerësimi për Ditën Studimore nr.1





Pyetësi për vlerësimin e Ditës Studimore të mbajtur më 03.02.2023, me temë "*Kërkimi i literaturës shkencore dhe i burimeve të informacionit*", synon të mbledhë opinione dhe sugjerime nga pjesëmarrësit për të përmirësuar cilësinë e aktiviteteve të ardhshme.

Rezultatet tregojnë se pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht organizimin dhe përmbajtjen e aktivitetit, me 88% të tyre që e kanë cilësuar informacionin si koherent dhe 13% si shumë të vlefshëm. Nuk ka pasur vlerësime negative për këtë aktivitet. Këto vlerësime tregojnë se trajnimi ka qenë efektiv në ofrimin e informacionit të qartë dhe të dobishëm për doktorantët. Megjithatë, disa sugjerime për përmirësim përfshijnë shtimin e shembujve praktikë gjatë leksioneve dhe ofrimin e alternativave online për pjesëmarrësit që nuk mund të jenë fizikisht të pranishëm. Këto vlerësime dhe rekomandime janë të rëndësishme për të siguruar që aktivitetet e ardhshme të jenë sa më efektive dhe të dobishme për doktorantët.

– Dita Studimore "Metodologjitë e avancuara në kërkimin shkencor"

Dita Studimore "Metodologjitë e avancuara në kërkimin shkencor", e mbajtur më 29 shtator 2023 në kuadër të Ditës Europiane të Kërkimit Shkencor, synonte të rrisë interesin e kërkuesve të rinj për karrierën shkencore dhe kërkimore. Aktiviteti kishte për qëllim të ndihmonte në promovimin e bashkëpunimit ndërmjet studiuesve të rinj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (FGJH). Duke ofruar metodologji të avancuara dhe teknika të reja në kërkimin shkencor, kjo ditë studimore u përpoq të pajisë pjesëmarrësit me aftësi dhe njohuri të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e kërkimeve të tyre. Përmes prezantimeve dhe diskutimeve interaktive, aktiviteti synonte të krijonte një mjedis të favorshëm për shkëmbimin e ideve dhe përvojave ndërmjet studiuesve të rinj, duke kontribuar kështu në zhvillimin e kapaciteteve të reja kërkimore.





Rezultatet e Nxjerra:

- **Interesi për Karrierën Shkencore:** Aktiviteti ka treguar një rritje të interesit të kërkuesve të rinj për karrierën shkencore dhe kërkimore. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht prezantimet dhe diskutimet interaktive, duke theksuar rëndësinë e metodologjive të avancuara në kërkimin shkencor.
- **Promovimi i Bashkëpunimit:** Një aspekt i rëndësishëm i aktivitetit ka qenë promovimi i bashkëpunimit ndërmjet studiuesve të rinj. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të shkëmbejnë ide dhe përvoja, duke krijuar një mjedis të favorshëm për bashkëpunim dhe zhvillim të kapaciteteve kërkimore.
- **Aftësitë dhe Njohuritë e Reja:** Prezantimet dhe sesionet praktike kanë ndihmuar pjesëmarrësit të pajisen me aftësi dhe njohuri të reja, të cilat janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së kërkimeve të tyre. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht përbajtjen e prezantimeve dhe qartësinë e informacionit të ofruar.


Analiza:

- **Pikat e Forta:** Aktiviteti ka arritur të rrisë interesin për karrierën shkencore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërmjet studiuesve të rinj. Prezantimet dhe sesionet praktike kanë qenë efektive në ofrimin e metodologjive të avancuara dhe teknikave të reja në kërkimin shkencor.

- **Pikat e Dobëta:** Megjithëse aktiviteti ka qenë i suksesshëm, mund të ketë nevojë për përmirësime në organizimin e sesioneve praktike dhe ofrimin e më shumë shembujve konkretë gjatë prezantimeve.
- **Rekomandime:** Për të maksimizuar efektivitetin e aktiviteteve të ardhshme, rekomandohet që të përfshihen më shumë shembuj praktikë dhe të ofrohen alternativa online për pjesëmarrësit që nuk mund të jenë fizikisht të pranishëm. Gjithashtu, mund të jetë e dobishme të organizohen sesione të veçanta për diskutime dhe shkëmbim idesh ndërmjet studiuesve të rinj.

– Kurse ekstrakurrikulare për doktorantët, Specializimi Smart S3

Universiteti i Tiranës ofron kurse ekstrakurrikulare për doktorantët, të cilat synojnë të mbështesin formimin sa më cilësor të studiuesve të rinj. Këto kurse janë të disponueshme për studentët doktorantë në fakultete të ndryshme dhe ofrojnë mundësi të vlefshme për zhvillimin akademik dhe profesional.



Analiza: Rezultatet tregojnë se këto kurse janë të rëndësishme për përgatitjen e doktorantëve për sfidat e karrierës shkencore. Pjesëmarrësit kanë vlerësuar pozitivisht cilësinë e mësimdhënies dhe përmbajtjen e kurseve, duke theksuar se ato ndihmojnë në përmirësimin e aftësive kërkimore dhe akademike. Megjithatë, për të maksimizuar efektivitetin e këtyre kurseve, rekomandohet që të përfshihen më shumë shembuj praktikë dhe të ofrohen metoda interaktive të mësimdhënies. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive të kërkuesve të rinj dhe në përgatitjen e tyre për sfidat e ardhshme në fushën e kërkimit shkencor.

V. Pikat e Forta

Pikat e forta për kërkimin shkencor dhe mbështetjen që ofron fakulteti për doktorantët janë elemente kyçe që mund të ndikojnë shumë në suksesin e një programi doktoral. Fakulteti ofron një mjedis të pasur që mundëson zhvillimin e aftësive kërkimore, promovimin e inovacionit dhe ndihmën për ndërtimin e një karriere akademike dhe profesionale.

Së pari: Një aspekt i rëndësishëm është mbështetja akademike, parë në dy këndvështrime:

- *Udhëheqës me eksperiencë dhe ekspertizë:* Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron mundësi për doktorantët të punojnë me profesorë dhe kërkues të njohur dhe të kualifikuar në fushën e tyre. Këta drejtues mund të ofrojnë udhëzim të vlefshëm për zhvillimin e kërkimit dhe përgatitjen e disertacionit.
- *Mbështetje për zhvillimin profesional:* Profesorët dhe udhëheqësit doktoral mund të ndihmojnë doktorantët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme për karrierën, përfshirë shkrimin shkencor, prezantimin e punës dhe udhëheqjen e projekteve kërkimore.

Së dyti: Pikë tjetër e rëndësishme janë burimet dhe infrastruktura për kërkim:

- *Laboratorë dhe pajisje moderne:* Fakulteti mbështet kërkimin shkencor dhe ofron akses në laboratorë të pajisur me teknologji dhe pajisje të avancuara. Kjo mund të jetë thelbësore për zhvillimin e kërkimeve eksperimentale dhe për realizimin e studimeve të thelluara.
- *Burime elektronike dhe biblioteka:* Akses në burime të pasura elektronike dhe biblioteka me revista shkencore, libra dhe materiale kërkimore të tjera është një mundësi e shkëlqyer për të zhvilluar një kërkim të thelluar dhe të informuar. Përveç kësaj, fakulteti ofron gjithashtu qasje në databaza dhe softuerë të specializuar për kërkime.

Së treti: Mundësi për Pjesëmarrje në Projekte Kërkimore dhe Bashkëpunime:

- *Projekte kërkimore të mbështetura nga fondet:* Fakulteti shpesh ofron mundësi për doktorantët të angazhohen në projekte kërkimore që janë të financuara nga burime të ndryshme. Këto mundësi mund rrisin zhvillimin e aftësive kërkimore.

- *Bashkëpunime ndërkombëtare:* Fakulteti mund të ofrojë mundësi për të punuar me kërkues ndërkombëtarë përmes partneriteteve me universitete dhe institucionet kërkimore të tjera. Ky lloj bashkëpunimi është shumë i vlefshëm për zgjerimin e horizonteve kërkimore dhe zhvillimin e një rrjeti profesional ndërkombëtar.

Së katërti: Aktivitetet Akademike:

- *Konferenca dhe seminare:* FGJH shpesh organizon ngjarje akademike, si konferenca, seminare dhe simpoziume, ku doktorantët mund të prezantojnë kërkimet e tyre dhe të ndërtojnë lidhje me profesionistë të fushës. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për rrjetëzim dhe për t'u bërë të njohur në komunitetin akademik.
- *Workshope dhe trajnime:* Fakulteti ofron në mënyrë të vazhdueshme mundësi trajnimi për zhvillimin e aftësive të kërkimit, si përdorimi i softuerëve të avancuar, shkrimi shkencor, menaxhimi i projekteve dhe teknikat e prezantimit.

Së pesti: Mjedisi shkencor dhe bashkëpunues:

- *Kultura e kërkimit dhe inovacionit:* Fakulteti investon në kërkimin shkencor për krijimin e një mjedisi që nxit inovacionin dhe mendimin kritik. Ky mjedis mund të inkurajojë doktorantët të zhvillojnë ide të reja dhe të sfidojnë kufijtë e njohurive ekzistuese.
- *Përkrahja për zhvillimin personal dhe profesional:* Fakulteti ofron mundësi për zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale përmes trajnimeve, këshillave dhe aktiviteteve që inkurajojnë rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e karrierës.

Përmbledhtasi mund të thuhet, se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron mbështetje të fortë për kërkimin shkencor dhe doktorantët janë ato që kanë një strukturë të pasur dhe të larmishme mbështetjeje, duke përfshirë mentorimin, burimet e avancuara, mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbështetje për karrierën. Këto mundësi ndihmojnë doktorantët të zhvillohen si kërkues të pavarur, të krijojnë mundësi për karrierë dhe të kontribuojnë në avancimin e njohurive shkencore.

VI. Aspekte për t'u përmirësuar

Ka disa aspekte që mund të përmirësojnë përvojën dhe mbështetjen që u ofrohen doktorantëve, duke e bërë programin më cilësor dhe efektiv. Këtu janë disa prej aspekteve që FGJH si institucion mund të përmirësojë për programin doktorant:

- *Përmirësimi i mundësive për publikim:* Edhe pse fakulteti ofron mundësi për publikim, ndihma për shkrimin dhe publikimin mund të jetë më e strukturuar.

- *Përkrahje më e madhe për doktorantët që nuk kanë eksperiencë të mëparshme në publikime:* Ndonjëherë, doktorantët që janë në fillim të karrierës kërkimore mund të kenë vështirësi në botimin e punimeve të tyre. Fakulteti mund të ofrojë mundësi për mentorim dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për të ndihmuar doktorantët në publikimin e punës së tyre.
- *Mbështetje më efikase për kërkimin shkencor:* Programet doktorale ofrojnë burime dhe mundësi të pasura kërkimore, mentorim nga ekspertë dhe mundësi për bashkëpunim ndërkombëtar dhe janë thelbësore për suksesin e doktorantëve. Kjo mbështetje është e rëndësishme për krijimin e kërkimeve të dobishme dhe për zhvillimin e aftësive shkencore dhe profesionale.
- *Kritjen e Kulturës së bashkëpunimit dhe inovacionit:* Një program i suksesshëm doktorial nxit krijimin e një mjedisi që inkurajon bashkëpunimin, shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e mendimit kritik. Kjo është e rëndësishme për promovimin e risive dhe për krijimin e një komuniteti akademik të fortë dhe të lidhur.

VII. Përfundime dhe rekomandime:

Ka disa aspekte që mund të përmirësohen dhe përmirësohen për të mundësuar një zhvillim më të mirë të aftësive kërkimore dhe profesionale të doktorantëve, dhe për të krijuar mundësi më të mira për karrierën e tyre pas doktoratës. Një program i suksesshëm doktorial duhet të jetë gjithmonë në përputhje me zhvillimet shkencore, teknologjike dhe profesionale, dhe të sigurojë një mjedis mbështetës që mundëson avancimin dhe arritjen e potencialit të plotë të doktorantëve.

Përfundime:

1. **Mbështetje Akademike dhe Profesionale:** Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron udhëheqës me eksperiencë dhe ekspertizë, të cilët ndihmojnë doktorantët në zhvillimin e kërkimit dhe përgatitjen e disertacionit, si dhe në zhvillimin e aftësive të rëndësishme për karrierën.
2. **Burime dhe Infrastrukturë Moderne:** Fakulteti ofron akses në laboratorë të pajisur me teknologji të avancuara dhe burime elektronike të pasura, duke përfshirë biblioteka dhe databaza të specializuara, që janë thelbësore për zhvillimin e kërkimeve të thelluara.
3. **Mundësi për Projekte Kërkimore dhe Bashkëpunime Ndërkombëtare:** Fakulteti mbështet doktorantët në angazhimin në projekte kërkimore të financuara dhe ofron mundësi për bashkëpunime ndërkombëtare, duke zgjeruar horizontet kërkimore dhe rrjetin profesional.
4. **Aktivitete Akademike dhe Trajnime:** Fakulteti organizon konferenca, seminare dhe workshope, ku doktorantët mund të prezantojnë kërkimet e tyre dhe të ndërtojnë lidhje me profesionistë të fushës, duke përmirësuar aftësitë e tyre kërkimore dhe prezantuese.
5. **Mjedis Shkencor dhe Bashkëpunues:** Fakulteti krijon një kulturë kërkimi dhe inovacioni që nxit mendimin kritik dhe zhvillimin e ideve të reja, duke ofruar gjithashtu mbështetje për zhvillimin personal dhe profesional të doktorantëve përmes trajnimeve dhe këshillave.

Rekomandime:

1. Përmirësimi i mundësive për publikim dhe trajnime për shkrimin shkencor:

- Të ofrohen mundësi më të shumta për doktorantët për të publikuar kërkimet e tyre në revista të njohura dhe për të marrë mbështetje më të drejtpërdrejtë për shkrimin dhe redaktimin e artikujve shkencorë.
- Rritja e aksesit në litteraturën bashkëkohore, duke mundësuar abonime në revista të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Nxitja e mobiliteteve për studentët

- Ofrimi i mundësive të mobiliteteve me qëllim jo vetëm rritjen e bashkëpunimit me institucionet partnere por edhe fitimin e përvojave ndërkombëtare në kërkime shkencore dhe në hartimin e temave.

3. Rritja e numrit të marrëveshjeve me Universitetet partnere

- Kjo si dhe më lart gjithashtu për të mundësuar mobilizimin por edhe për të hartuar programe të përbashkëta / të dyfishta doktoraturash të cilat do të ndikonin në rritjen e cilësisë së programe që FGJH ofron.

4. Vijimësia e një përfshirjeje më të madhe të studentëve në projekte dhe aktivitete të ndryshme

- Praktika pozitive e ndjekur nga FGJH ka dhënë frytet e saj por është e nevojshme një nxitje dhe përfshirje më e madhe e këtyre studentëve në këto projekte me qëllim fitimin e përvojave kërkimore si dhe krijimin e kërkuesve të vërtetë shkencorë për të ardhmen.

5. Përmirësimi i mundësive për zhvillimin e aftësive profesionale dhe menaxhimin e karrierës:

- Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen të zhvillojnë aftësi të shkrimit profesional dhe menaxhimit të projekteve për të krijuar mundësi më të mira për karrierën.

Në mënyrë të përmblëdhur theksojmë, se për të përmirësuar programet dhe për të krijuar një mjedis që nxit zhvillimin e aftësive kërkimore dhe profesionale të doktorantëve, është e rëndësishme që fakultetet të investojnë në përmirësimin e mbështetjes akademike, burimeve kërkimore, mundësive të rrjetëzimit dhe përgatitjes për karrierën pas doktoratës. Ndihamë për zhvillimin e aftësive praktike, përmirësimi i mbështetjes për shëndetin mendor dhe mundësitë e përmirësuar për publikimin e kërkimeve janë aspekte që mund të ndihmojnë në rritjen e suksesit të doktorantëve dhe në zhvillimin e një programi doktoral të fuqishëm dhe efektiv.

Aneks 1.

Formular për shqyrtimin e progresit të kërkimeve të studentit

A. Seksioni me të dhënat e përgjithshme :

1. Në cilin departament jeni i regjistruar:
a. Gjuha angleze b. Gjuha italiane c. Gjuha frënge d. Gjuha gjermane e. Gjuha turke
f. Gjuha spanjolle g. Gjuha greke
 2. Në çfarë viti të doktoraturës jeni aktualisht: 1 2 3 4 5
 3. Parashikoni ta mbyllni disertacionin brenda afatit të parashikuar : po/jo.
Nëse jo, pse? Sillni arsye.
-

B. Seksion lidhur me mbështetjen institucionale

1. A keni gjetur mbështetje nga Departamenti përkatës:
a) aspak b) deri diku c) mjaftueshëm d) shumë
2. A ju është ofruar informacion për pjesëmarrje në konferenca/kongrese/seminare kombëtare dhe ndërkombëtare: *aspak b) deri diku c) mjaftueshëm d) shumë*
3. A ju është ofruar informacion lidhur me publikimet në revista brenda dhe jashtë vendit:
aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë
4. A ju është ofruar informacion lidhur me publikimet në revista me SCOPUS:
aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë
5. A jeni ndjerë të mbështetur nga Zyra e Kërkimit shkencor dhe personeli përgjegjës për doktoraturat: *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
6. Sa i është përgjigjur nevojave tuaja kjo zyrë: *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
7. Në cilat aspekte e keni ndjerë mbështetjen: klikoni mbi çdo opsion që e merrni në konsideratë:
☐ Në përpilimin e dokumentacionit të kërkuar në vazhdimësi
☐ Në aksesimin në bibliotekë
☐ Në takimet e vazhduara që na ofrohen nga departamenti
☐ Në informacionet që na ofrohen lidhur me pjesëmarrjet në konf,
☐ Në informacionet që na ofrohen për publikime
☐ Në ditët studimore që organizohen nga FGJH
☐ Në ditët e trajnimeve organizohen nga FGJH
☐ Në aspektin financiar (tarifa, botime)
☐ Në përfshirjen në projekte të FGJH/ UT/ AKKSHI

C. Seksion lidhur me udhëheqësin:

1. A jeni ndjerë të mbështetur siç duhet nga udhëheqësi: *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
2. A ju motivon ai mjaftueshëm në rastet kur kjo është e nevojshme: *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
3. A ju ka ofruar ai informacionet e duhura dhe të mjaftueshme lidhur me kërkimin : *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
4. A keni diskutuar dhe rënë në dakordësi lidhur me çështje që kanë të bëjnë me temën dhe a janë të qarta komentet e tij : *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
5. A ju ka drejtuar ai lidhur me publikimet: literatura, kontrolli, rishikimi, diskutimi, komentet lidhur me to: a) *aspak* b) *deri diku* c) *mjaftueshëm* d) *shumë*
6. A i përmbahet ai etikës së komunikimit : *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*
7. A e merrni në konsideratë ndërrimin e udhëheqësit : *aspak / deri diku / mjaftueshëm / shumë*

Objektivat tuaja për vitin e ardhshëm janë:

- ☐ Gjetja e literaturës kryesore
- ☐ Pjesëmarrje në konferenca/kongrese
- ☐ Botimin e kumtesave me proceeding
- ☐ Botimin e artikujve
- ☐ Prezantimin e radhës
- ☐ Hartimin e pjesës teorike mbështetëse të temës
- ☐ Hartimin e pjesës operative/kërkimore, analiza, interpretimi i të dhënave, korpusit gjuhësor.
- ☐ Mbrojtja e temës
- ☐ Shtyrja e temës për arsye personale

D. Seksion lidhur me nevojat tuaja lidhur me punimi doktoral

➤ Cilat janë nevojat tuaja lidhur me punimin doktoral?

- ☐ Literaturë të huaj.
- ☐ Bibliotekë më e pasur me botimet e fundit
- ☐ Mundësi aksesimesh në revista të huaja që janë me pagesë të ofruara nga FGJH.
- ☐ Një paketë programi SPSS në FGJH për përpunimin e të dhënave që do dalin nga kërkimi.
- ☐ Një sistem antiplagjiaturë në FGJH sipas detyrimit ligjor.
- ☐ Një specialist statistikash mbështetës për analizat e nevojshme të të dhënave që dalin nga kërkimet.
- ☐ Komunikim më efikas me udhëheqësin

- ☐ Mbështetje më e madhe nga udhëheqësi
- ☐ Mbështetje më e madhe nga departamenti
- ☐ Ditë studimore më praktike dhe më pak teorike
- ☐ Trajtime efikase lidhur me metodologjinë kërkimore dhe shkrimin e tezës dhe të artikujve shkencorë.
- ☐ Takime të detyruara fizike/online me udhëheqësin 1-2 në muaj.
- ☐ Tjetër _____